

29.03.2023
Ora 14:54

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotesojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së votimit dhe numerimit elektronik të votuesve në qendrën e votimit, si dhe procedurave të rekrutimit”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

Komisioni Rregullator:

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Stafi KQZ: Y.Merkaj

Parti Politike: PDIU (Sh. Sulo)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të disa partive politike dhe të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme kemi një çështje për shqyrtim. Shqyrtimin e projektvendimit për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotesojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së votimit dhe numerimit elektronik të

Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

votuesve në qendrën e votimit, si dhe procedurave të rekrutimit. Paraprakisht pyes kolegët nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar?

Paneli i Rregullatorit: Jo.

Znj. I. Nano: Ju, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe shqërisë civile, ndonjë çështje jashtë rendit të ditës?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Jo.

Znj. I. Nano: Mirë fillojmë atëherë me shqyrtimin e projektaktit i cili ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj ju lutem një paraqitje të shkurtër të projektvendimit dhe shpjegimeve përkatëse.

Z. Y. Merkaj: Neni 23 i Kodit Zgjedhor përcakton se, sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit në zgjedhje vihen në përdorim nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveçse kur Rregullatori vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privatë të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin e shërbimeve. Duke qenë se përdorimi i këtyre pajisjeve do të bëhet nga persona të punësuar nga KQZ-ja, kemi përgatitur një projektvendim për caktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjeve të votimit dhe numrimin elektronik të votuesve në qendrën e votimit si dhe procedurat e rekrutimit të tyre. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat e pranimit dhe trajnimit të personelit që do të caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si operator teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për votimin dhe numërimin elektronik të zgjedhësve në qendrat e votimit. Ky projektvendim ka për objekt të përcaktojë kushtet dhe kriteret që duhet të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

plotësojnë shtetasit shqiptar që caktohet si operator teknik për përdorimin e pajisjes PEVN, procedurat e përzgjedhjes dhe të caktimit të operatorit teknik, përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit. Pranimi i operatorëve teknikë bëhet në bazë të parimit të konkurimit të hapur. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall publikisht thirrjen për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ofrojnë këtë shërbim. Thirrja publike përmban kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve si dhe mënyrën dhe afatin e aplikimit. Aplikimi nga të interesuarit kryhet në faqen elektronike të Komisioni Qendror Zgjedhjeve. Ky proces do të drejtohet dhe monitorohet nga Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve. Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit dhe i drejtohem Komisionit Rregullator për miratimin e këtij projektvendimi.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj. Fillojmë atëherë me shqyrtimin e projektaktit. Jemi në fazën e shqyrtimit në parim. Nëse ka diçka në parim nga anëtarët e Rregullatorit, subjektet apo shoqëria civile? Nuk kemi diçka. Atëherë e votojmë në parim projektin.

Kush është dakord në parim me projektaktin?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Neni 1, "Qëllimi dhe objekti".

1.Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat e pranimit dhe trajnimit të personelit që do të caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ, si operator teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për votimin dhe numërimin elektronik të zgjedhësve në qendrat e votimit.

2. Qëllimi është të përcaktojë:

*Zbardhi materialin audio
Artinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

- a. kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë shtetasit shqiptar që caktohet si operator teknik për përdorimin e pajisjes PEVN.
- b. Procedurat e përzgjedhjes dhe të caktimit të operatorit teknik.
- c. Përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit.

Kolegë lidhur me nenin 1, “Qëllimi dhe objekti”? Nuk kemi diçka. Kalojmë në votimin e nenit 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 2, “Papajtueshmëritë me detyrën e operatorit teknik”

Pika 1. Nuk mund të caktohet si operator teknik, shtetasi i cili:

- a) Ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt dytë, ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën operatori teknik është caktuar;
- b) Është ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës Republikës, Ministrisë së Brendshme, i Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencisë së Mbikqyrjes Policore dhe shërbimeve të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër.

Keni diçka kolegë lidhur me nenin 2? Zonja Vukaj po.

Znj. H. Vukaj: Për sa i përket përmbajtjes së kësaj dispozite do ta konsideroja më të plotë dhe më të konsoliduar në rast se do të shtonim... Meqenëse edhe vepimtaria e operatorit në pajisje nuk është thjesht dhe vetëm identifikimi, por ka një detyrë më të rëndësishme. Është ajo e votimit elektronik dhe e numërimit. Do të kisha preferuar që të shtonim edhe punonjësit e agjencive qeveritare të teknologjisë dhe informacionit dhe të sigurisë kibernetike. Meqenëse profile të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

tilla si IT, apo inxhinierë në fushën elektronike që bëjnë pjesë në këto agjenci të kishin një lloj papajtueshmërie me aplikimin në këtë funksion. Atëherë unë propozoj që në vijim të pikës b të kemi si propozim fjalinë që sapo e thashë dhe po e përsëris, “si dhe punonjës të agjencive qeveritare të teknologjisë dhe informacionit dhe sigurisë kibernetike, faleminderit”.

Znj. I. Nano: Ndonjë propozim tjetër për nenin 2 ka? Atëherë votojmë propozimin e zonjës Vukaj për të shtuar në germën b, të pikës 1, “si dhe punonjës të agjencive qeveritare të teknologjisë dhe informacionit dhe sigurisë kibernetike”

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë tek neni 3, “Kushtet për t’u caktuar operator teknik”.

1. Pranimi i operatorëve teknikë bëhet në bazë të parimit të konkurrimit të hapur.
2. Kandidati duhet të ketë të paktën arsim të mesëm. Në përzgjedhje, përparësi ka kandidati me arsim të lartë.
3. Kandidati për operator teknik duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:
 - a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një vepre penale;
 - c) nuk ka qenë anëtar i komisioneve zgjedhore dhe grupeve të numërimit në dy zgjedhjet e fundit;
 - ç) nuk është anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën tre vitet e fundit;
 - d) nuk ka qenë i përfshirë publikisht në veprimtari dhe aktivitete politike dhe elektorale për llogari të një subjekti zgjedhor në 5 vitet e fundit;
 - dh) të mos ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave;

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

e) të ketë njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit si kompjuter, smartphone, etj.;

ë) të jetë i gatshëm për të ofruar shërbimin edhe larg vendbanimit.

4. Operatori teknik duhet të jetë me vendbanim në territorin e zonës zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit ku ai do të caktohet nga KQZ. Përjashtimisht për rastet e qendrave të votimit, për të cilat nuk ka pasur aplikime, apo refuzohen nga aplikuesit, Komisioneri cakton, me pëlqimin e tij paraprak, edhe një operator që nuk është me banim në atë zonë zgjedhore.

Atëherë lidhur me këtë nen unë kam një saktësim dhe një propozim. Në pikën 2 thuhet “Kandidati duhet të ketë të paktën arsim të mesëm”. Referuar ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Mendoj se duhet përcaktuar arsim të mesëm të lartë. Që nënkupton ligjin parauniversitar. Në fakt kemi patur të njëjtin standart edhe kur kemi miratuar kriteret për caktimin e operatorëve të PEI-t. Pra thjesht saktësim është ky.

Po zoti..

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Faleminderit zonja kryetare: Une do të isha që në pikën 2 të vendosej “ Kandidati duhet të ketë arsim të lartë. Për faktin që nëse në krye të këtij relacioni, të këtij projektakti themi që mbështetet në nenin 20 të Kodit Zgjedhor, i cili thotë që për përdorimin e pajisjeve elektronike kërkohet personel i kualifikuar nga ana e KQZ-së. Dukë qenë se ne jemi me pritshmëri për të ecur në të gjithë territorin e Shqipërisë, për të bërë votimin elektronik dhe për të krijuar një grup njerëzish, të specializuar për këtë fushë, unë do të isha i mendimit se kandidati duhet të jetë me arsim të lartë, për faktin dhe të përgjegjësive dhe gjërave të tjera që ai duhet të ketë më pas. Po kështu, për pikat më poshtë unë do të sugjeroja që nëse është e mundur të shtohet që nuk ka qenë përfshirë, pika në fund fare, ose mbas pikës d të thuhet që nuk ka qenë anëtar i strukturave të grupit aktivist apo këtyre patronazhistëve, të cilët kanë bërë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

kërdinë në zgjedhjet e kaluara dhe në këto zgjedhje faktikisht i kemi prezent. Këtë do të sugjeroja unë për Komisionin. Pra, Kandidatët të jenë me arsim të lartë dhe të shtohet një pikë, “Nuk kanë qenë të përfshirë në strukturat e forcave politike, të cilat përmbajnë patronazhistë dhe aktivistë.

Znj. I. Nano: Të mbaroj dhe unë propozimin që kisha sepse kisha 2. Ka dhe zonja Vukaj dhe më pas i diskutojmë të gjitha. Kjo që thashë unë ishte saktësim, referuar ligjit të arsimit parauniversitar dhe në pikën e ku flasim që të ketë njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si kompjuter, smartphone etj. Unë do të thoja aftësi të mjaftueshme dhe këtë e kam si propozim, e para ishte saktësim. Zonja Vukaj ju?

Znj. H. Vukaj: Unë kam një propozim për ndryshim në fakt, tek pika d, e gjej më të përshtatshme, për hir të transparencës që duhet të sigurojë ky veprimtar, pra ky operator dhe njëkohësisht aftësitë që duhe të dëshmojë, tek pika d them të hiqet fjala publikisht sepse e garanton më mirë atë që përmenda, pra nuk ka qenë i përfshirë në veprimtari dhe aktivitete politike dhe elektorale për llogari të një subjekti zgjedhor në 5 vitet e fundit.

Znj. I. Nano: Pra jo publikisht por në çdo rast do të thoshit.

Znj. H. Vukaj: Po në çdo rast dhe kemi një saktësim, pika 3 përsëritet 2 herë, ndërkohë që duhet bërë pika 4, tek paragrafi i fundit, operatori teknik.

Znj. I. Nano: Lidhur me propozimet e deritanishme ka ndonjë koment nga kolegët përpara se të kalojmë në votimin një për një të propozimeve? Po.

*Zbardhi materialin audio
Artinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Më fal edhe pika dh “Të mos ndodhemi në kushtet e konfliktit të interesave”.... *(Pa mikrofon, nuk dëgjohet)*

Znj. I. Nano: Është në fakt është më i gjërë legjislacioni i konfliktit të interesave sesa kaq sa keni shpjeguar në mënyrë eksplicite më lart.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Dakord

Znj. I. Nano: Po kolegë ka diçka, ndonjë diskutim? Në fakt unë do të pyesja pak administratën lidhur me propozimin që po bën përfaqësuesi i partisë politike PDIU. Çfarë është patur parasysh kur është vendosur si standart minimat arsimit i mesëm i lartë sepse unë kam parasysh që i njëjti standart është mbajtur edhe tek kriteret për operatorët e pajisjeve elektronike të identifikimit të zgjedhësve. Një akt që ne para pak e kemi miratuar.

Z. Y. Merkaj: Thjesht më tepër për të patur lehtësi, për të zgjeruar dhe rrethin e personave që mund të marrin pjesë për tu punësuar sepse jemi në vështirësi dhe mund të jemi në vështirësi për të gjetur operatorë.

Znj. I. Nano: Keni patur dy procese që i keni kaluar këto... Nga vjet, nga parvjet çfarë ka rezultuar? Ka ndonjë problematikë?

Z. Y. Merkaj: Kemi patur vështirësi në gjetjen e personelit.

Znj. H. Vukaj: Rezulton që kanë sjellë probleme ata me shkollë të mesme? Pra kanë patur kapacitet të mjaftueshëm për të realizuar...Në kushtet e vakancave ose të ikjes së rinisë, e besoj deri diku që mund të gjendeni edhe në mungesë të operatorëve.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, nga eksperiencia e mëparshme dhe përdorimi i pajisjes nuk është shumë i vështirë, kemi shkruajtur që të ketë aftësi minimale, megjithatë mund të jenë të mjaftueshme, shumë dakord, por thjesht një person që di të përdorë të paktën telefonin dhe smartphonin dhe me trajnimin që do të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë kësaj periudhe, do të bëjë që edhe një person me shkollë të mesme mund ta përdorë pajisjen elektronike të votimit. Janë disa komanda shumë të thjeshta dhe të shkurtra, nuk janë komanda shumë të gjata që duhen mbajtur mend.

Z. M. Çakaj: Pra në vijim të propozimit që bëri përfaqësuesi i PDIU-së lidhur me parashikimin në Kodin Zgjedhor, më konkretisht me nenin 23 të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se personeli i punësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhet të ketë kualifikimet e nevojshme, nisur edhe nga eksperiencat e kaluara ju mendoni, ose më saktë është vënë re, tashmë është e provuar që edhe një person ka arsimin e mesëm të lartë me trajnimin që bën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me njohuritë e mjaftueshme edhe mund të konsiderohet i kualifikuar për të përdorur këto pajisje. Ju e konfirmoni këtë.

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. M. Çakaj: Dakord. Atëherë, i qëndron edhe pas këtij sqarimi propozimit përfaqësuesi?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Jo, meqenëse është kështu tërhiqem.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

Znj. I. Nano: Dakord, faleminderit! Atëhere fillojmë me votimin e propozimeve të bëra nga antarët e Rregullatorit, kjo e para besoj s'ka nevojë të votohet, arsimi i mesëm, i lartë është çështje saktësimi. Zonja Vukaj propozoi në pikën d, të hiqet fjala 'publikisht'.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Unë propozova zëvendësimin e fjalës "minimale" pra aftësi minimale me aftësi të mjaftueshme, dhe në fakt kjo ndoshta dhe adreson, edhe shqetësimin e ngritur nga përfaqësuesi i PDIU.

Kolegë kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Dhe gjatë zbardhjes të saktësohet pika 3 është 4. Po atëhere kemi propozimin, mund ta përmëndni dhe një herë, ju lutem pas germës d, thatë një germë tjetër, po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Në fakt, propozimi i përfaqësuesit të PDIU-së, është shumë intresant, shumë koherent, por unë kam vetëm një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duke marrë në konsideratë që me të gjithë operatorët teknikë, së pari do të vijojë një proces identifikimi, selektimi, pra do ta aplikojmë, a është e mundur që ta identifikojmë këtë problem? Në thelb, në thelb si patronazhim, në gjykimin tim personal, nuk e di çfarë mendojnë antarët e tjerë të komisionit, në gjykimin tim personal, si patronazhimi apo aktivisti, identifikon një përkatësi politike të caktuar. Ky është gjykimi im personal, dhe sigurisht që është i papajtueshëm me kushtet për tu caktuar operatorët teknik. Pyetja që shtrohet është thelbësisht teknike dhe operacionale. A mund ta identifikojmë dot ne këtë gjë?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

Z. Y. Merkaç: Kam përshtypjen që nuk mund ta identifikojmë, nuk kemi ku të bazohemi, megjithatë pika c dhe ç, e këtij neni i plotëson.

Znj. I. Nano: Madje dhe d-ja.

Z. M. Çakaj: Jo, jo nuk i plotëson, të jemi korrekt dhe të sinqertë, si me vetem tonë në rradhë të parë, po ashtu dhe me publikun, pasi kemi shumë përfaqësues të administratës, si të nivelit drejtues, si trupës të nënpunësve civil, ashtu edhe të administratës shtetërore, të cilët mund të kenë bindje të ndryshme politike por detyrohen të shkarkojnë aplikacionin, detyrohen të bëjnë (like) pëlqime, (share) shpërndarje pafund, a thua se pozicioni i tyre i punës funksionon me pëlqime dhe shpërndarje. Megjithatë kjo është tjetër histori.

Z. Y. Merkaç: Mund të shtojmë që mund të bëjnë një vetdeklarim ata që nuk janë..

Z. M. Çakaj: Vetëdeklarim që nuk janë patronazhistë?

Z. Y. Merkaç: Po se nuk kemi si vërtetojmë, verifikojmë.

Z. M. Çakaj: Interesante duket dhe kjo.

Znj. I. Nano: Po, po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Duke qenë se kam qenë e ingranuar në këtë proces për ta ekspozuar, e kam quajtur fenomen, sepse i tillë është, zotëria përfaqësues i një subjekti politik, me vend ngre këtë shqetësim, madje në respekt të këtij fenomeni edhe të padrejtësisë apo ndikimit që mund të sjellë, ai propozon një pikë shtesë,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

apriori ose në parim e gjej me vënd këtë propzim, dhe absolutisht zoti Merkaj mund të identifkohet, sepse listat që kanë qarkulluar të patronazhimit, gjenden sot në prokurori, në SPAK, dhe janë marr si prova materiale. Në të kundërt do ishin refuzuar kallzimet dhe do ishin zhvlerësuar si prova dhe sot do kishim një përgjigje nga prokuroria. Këtë e dinë të gjithë shqipëtarët se kë kemi patronazhist, si funksionajnë patronazhistët, sa në ngarkim na kanë, na kanë patur, dhe do na kenë në vijim, kështu që kjo është e identifikueshme, pra të gjithë disponojmë pak a shumë ato lista, të cilat kanë qarkulluar dhe i kemi ekspozuar pikërisht në këtë sallë, unë personalisht patronazhistin tim. Kështu që muns të identifkohet, për hir të itegritetit të këtij procesi.

Z. Y. Merkaj: Nuk e di çfarë mund të marrim për bazë nga një listë që është çuar në prokurori, që s'ka marrë vlerën e provës, është në hetim akoma, kështu që nuk e di si mund ta marrim.

Znj. I. Nano: Mirë, atëhere votojmë kolegë propozimin e përfaqësuesit të PDIU, për të shtuar një fërmë pas gërmës d, me përmbajtjen i përfshirë.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Nuk ka qenë i përfshirë në veprimtari apo aktivitete politike, të subjekteve politike, të cilat përmbajnë në vetvete organizata si patronazhistët dhe aktivistët. Pak a shumë kjo është ideja pastaj mund ta rregulloni me fjalë. Pra nuk bëjnë pjesë në këto struktura të patronazhistëve apo të aktivistëve.

Znj. I. Nano: Dakord, kalojmë në votimin e propozimit të përfaqësuesit të PDIU-së, për shtimin e një gërme mbas gërmës d, me përmbajtjen që sapo u lexua.

Kush është dakord kolegë?

Pro: **2 vota (znj. Vukaj, z. Çakaj)**

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

Kundër: 3 vota (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

Nuk miratohet propozimi! Atëhere votojmë nenin 3 në tërësi meqënëse patëm disa diskutime, shtesa, propozime.

Kush është dakord me 3 me ato çka u votua?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 4 paraqitja e kërkesës.

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shpall publikisht, thirrjen për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ofrojnë shërbimin si operator teknik për përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve në qendrën e votimit.
2. Thirrja publike sipas pikës 1, të këtij neni, përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim për kandidatët për operatorë teknikë, si dhe mënyrën dhe afatin e aplikimit.
3. Aplikimi nga të interesuarit kryhet elektronikisht duke plotësuar fushat përkatëse në portalin për aplikime në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.
4. Mosdeklarimi i saktë i të dhënave ose deklarimi i rremë i tyre sjell sipas rastit përgjegjësi penale ose administrative për aplikuesin. Kolegë keni diçka për nenin 4? Jo. Kalojmë në votimin e nenit 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 5, procedura e shqyrtimit të kërkesave.

1. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve, struktura përgjegjëse e administratës së KQZ-së, përgatit listën e shtetasve të cilët përmbushin kërkesat dhe kushtet për të qenë operator teknik, sipas përcaktimeve të neneve 2 dhe 3, të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

2. Shtetasit e përzgjedhur sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen trajnimit dhe testimit të njohurive, për shërbimin si operator teknik.
3. Shtetasit e përzgjedhur sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, të cilët nuk marrin pjesë në trajnim, apo nuk kalojnë testimin sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, nuk mundet të caktohen si operatorë teknikë.
4. Procesi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni drejtohet, mbikëqyret dhe monitorohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Lidhur me neni 5 kemi diçka, ndonjë pyetje, ndonjë propozim? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 6, caktimi i operatorëve teknikë.

1. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së zgjedhjeve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton operatorë teknikë shtetasit e përzgjedhur sipas nenit 5, të këtij vendimi.
2. Nëse për shkaqe të ndryshme operatori teknik i caktuar nuk paraqitet për ofrimin e shërbimit, në vend të tij caktohet një person tjetër, i cili është në listën e personave të përzgjedhur, sipas nenit 5 të këtij vendimi. Kemi diçka lidhur me neni 6? Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Atëhere në pikën 2 propozoj të shtojmë një shtesë, një fjali për tu bërë më e kompletuar gjithë pika, pra atje ku mbaron fjala 'të përzgjedhur', të shtonim: 'në fazën paraprake por ende i pacaktuar' dhe më pas vijon, sipas nenit 5 të këtij vendimi. Për të diferencuar personat.

Znj. I. Nano: Pra, në rastet e zëvendësimit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

Znj. H. Vukaj: Po, personat që zgjidhen dhe janë në listë pritjeje, por që ende nuk janë caktuar se ku do të pozicionohen, apo ku do të emërohen, le ta quajmë.

Znj. I. Nano: Edhe unë mendoj që kjo e saktëson më mirë procedurën. Nuk e di kolegët nëse kanë ndonjë koment? Nëse jo kalojmë në votimin e propozimit të zonjës Vukaj, për të shtuar pas fjalës: ‘ne listën e personave të përzgjedhur’ të shtohet “në fazën paraprake por ende i pacaktuar” dhe vijon sipas nenit 5 të këtij vendimi.

Kolegë kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet! Kalojmë tek neni 7, përgjegjësitë e operatorëve teknikë.

1. Operatori teknik ushtron përgjegjësitë dhe përmbush detyrat e tij në mënyrë të paanshme dhe në përputhje të plotë me aktet e KQZ-së.
2. Operatori teknik nuk ka rol vendimmarrës në lidhje me të drejtën e zgjedhësit për të votuar ose jo.
3. Operatori teknik është përgjegjës për vënien në punë dhe përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve vetëm në qendrën e votimit ku është caktuar, sipas manualit të përdorimit të saj dhe procedurave të përcaktuara në aktet e KQZ-së.
4. Operatori teknik nuk ka të drejtë të përgatisë dhe/ose të administrojë dokumentacion apo material zgjedhor.
5. Gjatë ushtrimit të detyrës, apo pas përfundimit të saj, nuk duhet të sigurojë, japë informacion apo bëjë publike për partitë politike, mediat, organizata të shoqërisë civile, të dhëna lidhur me ecurinë e procesit të votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve.
6. Operatorët teknikë mbajnë përgjegjësi civile dhe/ose penale për veprimet/mosveprimet e tyre në kundërshtim me kontratën dhe/ose legjislacionin

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

penal në fuqi.

7. Detyrat operacionale të operatorit teknik përcaktohen me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Lidhur me nenin 7, përgjegjësitë e operatorëve teknikë, kemi diçka? Jo. Kalojmë në votimin e nenit 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 8, ofrimi i shërbimit.

1. Ofrimi i shërbimit bëhet në përputhje me kontratën e nënshkruar ndërmjet KQZ-së dhe operatorit.

2. Operatorët teknikë për shërbimin e ofruar, përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

3. KQZ-ja mbulon shpenzimet e transportit për rastet kur operatori teknik ofron shërbimin jo pranë vendbanimit të tij. Përlllogaritja bëhet në përputhje me aktet normative përkatëse. Kemi diçka për nenin 8, ndonjë propzim? Jo. Kalojmë në votimin e nenit 8.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 9, votimi i operatorëve teknikë.

Operatorët teknikë votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar për të ofruar shërbimin sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Ndoshta këtu duhet të saktësojmë diçka, thamë që mundet ta ofrojë shërbimin e tij dhe në një qendër që nuk është në zonën e tij zgjedhore, kemi bërë të njëjtin diskutim edhe për operatorin e PEI-t kolegë, kështu që të njëjtin standart, të njëjtin parim, vetëm në një rast pamundësie për të plotësuar vëndet në një zonë zgjedhore ,mund të merret një operator nga një zonë tjetër zgjedhore. Që do të thotë, pra të shtojë, vetëm nëse është zgjedhës në këtë qendër votimi, në zonën zgjedhore, më falni, në zonën

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.03.2022*

përkatëse zgjedhore, dhe jemi në të njëjtin standart të miratuar dhe më herët për operatorët e PEI-t dhe shohim saktësisht siç e kemi miratuar te PEI. Kolegë e konsiderojmë një saktësim këtë, apo një propozim për shtesë? Për mua është një saktësim. Atëhere votojmë nenin 9 ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 10, hyrja në fuqi.

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Kalojmë tashmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi miratuar në parim dhe nen për nen.

Edhe njëherë kolegë, kush është dakord me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Meqënëse nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr.14

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

